

PROCESVERBAL-Tipi i kontratës-SHERBIME
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

DATE 18.9.2026

(Ky proces verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Hartimi i Planit të Mbarështrimit të Ekonomisë Pyjore ”Dropulli i Sipërm”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(CPV):90712200-3

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **4.906.666** (Kater milion e nenteqind e gjashte mijë e gjashteqind e gjashtedhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Dropull** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistroheshin në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/ f, c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, 2025**, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c ”c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Kapaciteti teknik:

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Pika 4. ”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në nenin 41 pika 3 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar “ ku përcaktohet se: Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. *Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

-Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.

-Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, minimalisht **12 (dymbëdhjete)** persona qe te figurojne ne listpagesat per tre muajt e fundit te deklaruar si më poshtë:

• Inxhinier Pyjesh (perfshirë dhe drejtuesin teknik)	6 (pesë)
• Inxhinier Pyjesh ose teknik pyjesh	2 (dy)
• Biolog	1 (një)
• Zooteknik	1 (nje)
• Inxhinier Gjeodet /Markshaider/Topograf	1 (nje)
• Shofer	1 (një)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në Manualin e Mbarështimit të Integruar të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me nr.864 prot., datë 30.01.2019 “Kontrolli i disponibilitetit dhe aftësive profesionale të stafit teknik”, si dhe në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, gërma c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me ane te ketij kriteri kerkohet qe opertoret ekonomike te deshmojne qe kane fuqine punetore te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, qe kane ne dispozicion apo qe mund ti vihen.

-6 (gjashtë) Specialistë Pyjesh (Inxhinier), të cilët do të jenë pjesë e grupeve të terrenit për ekonomin pyjore në studim (Stafit teknik) ku te paktën 4 (katër) nga inxhinierët që do të jenë lider të grupeve të punës në terren të jenë të pajisur me "Çertifikate profesionale", për shërbime profesionale për projekte sipas germës (c) pika 1 neni nr. 3, e Rregullores nr. 3, datë 08.07.2009, "Për çertifikimin e shërbimeve të ekspertizës dhe profesionale në pyje dhe kullota") me përvojë në fushën e pyjeve dhe kullotave, Hartimin e Planeve të Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, menaxhimit të tyre të qëndrueshëm, aspekteve Silvo-pastorale, të mbrojtjes dhe zhvillimit të burimeve natyrore, të ketë aftësi të mira organizative në grup etj. Kjo kerkese eshte e parashikuar ne "Manualin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave", të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019 per grupet e terrenit sipas pikes D, D.1.1."Perberja e ekipit te punes" secili nga ekipet e punes se terrenit duhet te perbehet nga 2 specialiste profesionale (inxhinjere pyjesh) dhe 1 specialist inxhinier ose teknik pyjesh (ekspert ne punen e terrenit).

Per inxhinierat e pyjeve perfshire dhe drejtuesin teknik duhet te paraqesin dokumentat si me poshte:

- 1) Kontratat individuale të punës (te vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit te kontrates)
- 2) Diplomë universitare.
- 3) Çertifikate profesionale nga MM per kategoritë c, për 4 (katër) inxhiniera pyjesh sipas VKM nr. 284 dt.29.04.2022 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave , kriterëve për pajisje me çertifikatë eksperti në fushën e pyjeve dhe kullotave .
- 4) Listpagesat per tre muajt e fundit te deklaruar

-2 (dy) Inxhinieret/teknik e pyjeve duhet te paraqesin

- 1) Kontratrat individuale të punës (te vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit te kontrates)
- 2) Diplomë universitare/diplome e shkolles s emesme.

3) Listpagesat per tre muajt e fundit te deklaruar

-1 (nje) Inxhinier Gjeodet për grupet e punës në ndarjen e ngastrave e n/ngastrave, përgatitjen e hartave të ndryshme sipas termave të referencës (dixhitalizimin, gjeoreferimin etj), përpunimin dhe menaxhimin e të dhënave dixhitale (Inxhinier topograf/gjeodet/), i pajisur me Liçencë në fushën e projekteve (për sistemet GIS) kategoria 8-C, nga autoritetet kompetente ligjore,

Për Inxhinierin Gjeodet duhet të paraqesin dokumentat si më poshtë:

- 1) Kontratat individuale të punës (te vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit te kontrates)
- 2) Diplomë
- 3) Licence në fushën e projekteve (për sistemet GIS) kategoria 8-C, leshuar nga autoritetet kompetente ligjore.
- 4) Listpagesat per tre muajt e fundit te deklaruar

-1 (një) Biolog ku manuali planeve të mbarështimit kërkon të dhëna për biotopet, habitatet, speciet e kërcënuara, vegjetacionin potencial, rezervat biogjenetike dhe rreziqet për biodiversitetin. Biologu mbulon analizën dhe interpretimin e këtij komponenti.

Për Biologun duhet të paraqesi dokumentat si më poshtë:

- 1) Kontratat individuale të punës (te vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit te kontrates)
- 2) Diplomë

- 1 (një) zooteknik ku Manuali i planeve të mbarështimit kërkon të analizohen llojet dhe numri i bagëtive, shpërndarja në kullota, kapaciteti mbajtës, niveli i kullotjes dhe nevojat e blegtorisë për bazë ushqimore. Këto detyra lidhen drejtpërdrejt me ekspertizën zooteknike

Për Zootechnikun duhet të paraqesi dokumentat si më poshtë:

- 1) Kontratat individuale të punës (te vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit te kontrates)
- 2) Diplomë

Personeli i cili është i punësuar pranë operatorit ekonomik ofertues të figurojë në listpagesat e tre muajve të fundit. Përfshihen nga detyrimi për të figuruar në listpagesa specialistet e kontraktuar nga jashtë.

1 (nje) Shofer

Për shoferin e kompanisë:

- 1) Listpagesë si i punësuar të paktën një muaj për periudhën e tre muajve të fundit të deklaruar
- 2) Kontrata e punës e vlefshme
- 3) Leja e drejtimit të mjetit sipas kategorive të miratuara nga institucioni përgjegjës për lëshimin e dokumentit të drejtimit të mjetit.

Ne rastin kur mjeti merret me qira shoferi nuk kërkohej të figurojë në listpagesat e shoqërisë operator ekonomik ofertues pasi mund të kontraktohet

Argumentim: Kërkesa e mësipërme në pikat 2.3.2, është përcaktuar në mbështetje të pikës 4 të nenit 77 të Lgjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në pikën 4 të gërma b, c e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ku përcaktohet shprehimisht se : 4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b)një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c)fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit dhe , në ”Manualin e planeve të mbarështimit të pyjeve

dhe kullotave”, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019, duke mare ne konsiderate se objekti ka nje siperfaqe te konsiderueshme te pyjeve e kullotave ,si dhe kohezgjatja e kontrates qe eshte per nje afat kohor 7 muaj .Per realizimin e kontrates duhen te pakten 2 grupe pune ne terren . Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të Lgjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në pikën 4 gërma b, c e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ku percaktohet shprehimisht : 4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b)një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c)fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, VKM nr. 284 dt.29.04.2022 “Per percaktimin e rregullave dhe procedurave , kriterëve per pajisje me çertifikate eksperti ne fushen e pyjeve dhe kullotave”;

Kërkesa për Inxhinieri gjeodet është e nevojshme per arsye se inxhinieri gjeodet do te merret me pergatitjen e hartave pyjore sipas Manualit te planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave”, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t’I vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates, si me poshte (sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit):

Lloji i mjetit/pajisjes	Sasia	Disponimi
Mjet transporti për personelin tip fuoristrade 4 x 4 për lëvizjet në zonat malore	2 copë	Pronësi/ose me qera
Aparat GPS	2 cope	Pronësi/ose me qera
Diametër matës	2 copë	Pronësi/ose me qera
Turjel për marrjen e kampionëve në diametër	2 copë	Pronësi/ose me qera
Lazer metër (distançë metër)	2 copë	Pronësi/ose me qera
Pjerresi mates+lartësi matës(Hypsometër) apo ekuivalent.	2 copë	Pronësi/ose me qera
Kompjuter dhe printera për punime zyre	2 copë	Pronësi/ose me qera
Busulla	2 copë	Pronësi/ose me qera
Metër shirit deri në 20m	2 copë	Pronësi/ose me qera
PH metër (Ph mates) për ph e tokës	2 cop	Pronësi/ose me qera
Klinometër	2 cop	Pronësi/ose me qera
Peshore për peshimin e barit	2 cope	Pronësi/ose me qera

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike Operatori duhet të paraqesë:

- Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe certifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Për mjetet (pajisjet e punes) në pronësi të paraqitet fatura tatimore e blerjes në emër të kompanise blerëse.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit në Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore të blerjes.
- Për të gjitha mjetet (pajisjet e punës) të marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.
- Për mjetet e marra me qera që shënohen në regjistra publik, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brenda vëndit, (e vlefshme). Kurse për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, si dhe Neni 39, pika 6, germa "d", Neni 41, pika 4, germa "ç" të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Nëpërmjet këtyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Pajisjet e mesiperme nevojiten për marrjen, matjen, grumbullimin e të dhënave në terren
Kompjuter dhe printera nevojiten për punime në zyrë

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001:2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Çertifikatën e përpunimit të studimeve pyjore dhe projekteve, zhvillimi i planeve të mbarështimit në pyje e kullota ISO 27001:2022, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Çertifikata e mësipërme duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i publikuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Njesia e Prokurimit